



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. l prot. 2421 Më 02.07.2026
Br. prot. 2421 Dt. 02.07.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal Rahovec

Drejtoria për Adiminstratë të Përgjithshme

Raporti gjashtëmuor i punës

Janar-Qershor 2026

Raporti gjashtëmujor i punës Janar-Qershor 2026

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ka arritur që me sukses t'i realizojë objektivat e parapara për këtë vit.

Administrata si digaster i rëndësishëm i Komunës, ka për objektiv punë sa më efikase e më afër qytetarit, komunikim korrekt me të gjithë, ka bërë afirmimin e punës së Administratës Komunale, shërbime të shpejta si në formë fizike ashtu edhe në formë elektronike, ka trajtuar me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve, në mënyrë që qytetari të merr shërbimin më lehtë e më shpejtë.

Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, statutit të Komunës, vendimeve të Kuvendit të Komunës janë prioritet i lartë i drejtorisë.

Në kuadër të Drejtorisë për Administratë funksionojnë këta sektorë:

Sektori i Gjendjes Civile, Sektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve, Sektori për IT, Sektori për të Drejtat e Njeriut, Sektori për Barazi Gjinore, Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve.

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Qendra për Shërbim me Qytetarë është pjesë e strukturës organizative të administratës.

Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ si: pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet tjera. Këto kërkesa/parashtresa, të kompletuara përcillen në drejtoritë e administratës komunale, varësisht ku pala parashton për shqyrtim dhe vendosje.

Komunikimin e drejtpërdrejtë, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënien e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative, ligjore, afatet kohore të paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave dhe parashtresave si në formën klasike ashtu edhe përmes formës elektronike /intranetit, përgatitja dhe vënia në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët, mbajtja e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypjen e librit të protokollit për kërkesat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

Kërkesat e pranuar gjatë periudhës Janar-Qershor 2026

Në drejtorinë e Administratës së përgjithshme gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar kryesisht kërkesa që kanë të bëjnë me kërkesat që janë drejtuar në drejtoritë e tjera e që sipas rregullores për taksa, tarifa gjoba dhe ngarkesa, kanalizohen përmes drejtorisë sonë.

Drejtoria e Administratës	Shenja e klasifikimit	Nr. I kërkesave	Te paguara	Te liruar	gjithesëj
Kerkesa/Ankesa	320/04	3648		225	3,903
Mbajtes familje	040/01	633/10euro	633	//	6,330
Vërtetime te ndryshe	320/04	229/2euro	149	80	149
Referenca	320/04	4/50 euro	4		200
					10,582.00€

Sektori I Gjendjes Civile

Gjatë këtij gjashtëmujori në sektorin e Gjendjes Civile janë lëshuar këto dokumente:

Certifikata dhe Ekstakt të Lindjes	11,679
Certifikate e Shtetesis	55
Certifikate e Marteses	2491
Certifikate e Vdekjes	961
Certifikate e Vendbanimit	1073
Certifikate e Gjendjes Martesore	570
Deklerate per bashkesine familjare	1152
Vertetim nga Arkivi	261

Lindjet Vendore	13
Lindjet e Jashtme	250
Martetat Vendore	173
Martetat e Jashtme	49
Martesa me shtetesi te huaj	21
Vdekjet Vendore	93
Vdekjet e Jashtme	30
Aktvdekjet	133
Pranimi i atësisë	5
Aktvendim - Korrigjimi I Emrit Personal	5

Aktvendim - Regjistrimi I Lindjes se Mevonshem	2
Aktvendim - Regjistrimi I Vdekjes se Mevonshem	17
Aktvendim - Nderrimi I Emrit Personal	16
Aktvendim - Anulimet e Regjistrimeve te Dyfishuar	3
Aktvendim - Riregjistrimi I Vdekjes	5
Aktvendim - Riregjistrimi I Lindjes	1

Në Sektorin e Gjendjes Civile, janë lëshuar **18242** dokumente të ndryshme.

Të hyrat financiare në Drejtorin e Administratës së Pergjithshme për periudhën Janar – Qershor 2026 janë **29,739.00 Euro**

Sektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve

Për të gjitha takimet e mbajtura gjatë periudhës 5 mujore të vitit 2026, është bërë përgatitja profesionale dhe teknike e materiale, lektorimi, shumëzimi dhe ekspedimi me kohë të tyre, si dhe janë përcjellë dhe janë mbajtur procesverbale, po ashtu është ofruar ndihmë në mbarëvajtjen e punës së Kuvendit, Po ashtu në këtë zyre janë përkthyer të gjitha materialet e Kuvendit, Komiteteve, procesverbalet, po ashtu janë përkthyer edhe materialet e ekzekutivit. Në vijim të këtij Raporti po ju sjellim në mënyrë tabelare numrin e mbledhjeve të mbajtura në muajin Janar-Maj 2026: Mbledhjet e Kuvendit të rregullta, të jashtëzakonshme, emergjente, solemne dhe komemorative,

Nr.	Kuvendi dhe trupat e tij	Mbledhjet e Kuvendit të rregullta	Seancë Përkujtime re	Solemne	KPF	KKSB	K.Komun itete	K.Per persona me aftësi te kufizuar
1.	Numri i takimeve	6	0	2	5	2	2	2

Në vijim në mënyrë tabelare do ju paraqesim edhe numrin e pikave të shqyrtuara dhe miratuara në mbledhjet e rregullta të kuvendit komunal në muajin janar- mars 2026.

	Emërtimet	Nr. Pikave të shqyrtuara	Konf. Ligjshmërisë nga MAPL	Rishqyrtim Ligjshmërisë nga KK
1.	Mbledhjet e Kuvendit të rregullta	59	31	5

Sektori për IT

Gjatë periudhës janar – qershor 2026 kemi vazhduar me punët tona rutinore, kontrollimi i rrjetës, pajisjeve të teknologjisë informative.

Kemi bërë rikonfigurimin e disa kompjuterëve, kemi bërë inspektimin e kompjuterëve, kemi monitoruar vazhdimisht ecurinë e punëve në sistemin e intranetit, kemi monitoruar funksionimin e ueb faqes, po ashtu me kërkesa të ndryshme edhe kemi publikuar materiale në ueb faqe. Gjatë kësaj periudhe të gjitha takimet e mbajtura në sallën e kuvendit komunal (mbledhjet e kuvendit komunal, KPF, KKSBB dhe të gjitha komitetete tjera, i kemi përkrahur dhe sipas nevojës i kemi transmetuar në ueb faqe të komunës.

Kemi pasur edhe kërkesa për krijimin e llogarive të reja për përdorimin e sistemeve qeveritare të cilat i kemi krijuar dhe në bashkëpunim me ASHI-në edhe i kemi autorizuar për përdorim.

Vazhdimisht kemi kërkesa AD-HOC nga zyrtar komunal, nga shkollat e komunës së Rahovecit, nga institucionet shëndetësore (QKMF, QMF, AMF) për intervenime në pajisjet e teknologjisë informative, të cilave po përpiqemi në maksimum të iu përgjigjemi.

Sektori për të Drejtat e Njeriut

Plotsimi i pyetsorit për obligimet e komunës nga Agjenda Evropjane* Plotesimi i Pyetsorit për MAPL (informata rreth aktiviteteteve të Komunës)

Takimet e rregullta me zyrtarin Ligjor të Avokatit të Popullit (ditët e hapura për qytetarët) Tre takime me Grupin e grave *1. takimi me qëdhim të njoftohen grat me temat që mund ti zhvillojm gjate këtij viti së bashku për aritjet dhe fuqizimin e grave në shoqëri

2. Njohja e grave me shërbimet e Infermijereve ne QKMF, 3. Takimi I grupit të grave me shërbimet dhe rendesin e Psikologut nëpër shkolla .

- Si Kryetare e Komisionit Komunal për Ri-atdhesim (KKR) bashk me antarët e këtij Komisionit kemi mbajtur 4 takime me Komisioni Komunal për Ri-atdhesim, vizita e rregullta me antaret e Komisionit , dhe me Koordinatorin Regjional dalim në teren për secilin rast para se të shqyrtohet rasti dhe janë shqyrtuar 6 Kerkesa :Nr. I Landes 416- data 14.01.2026 ,Nr. 590 – data 20.01.2026, Nr.912data - 18.02.2026, Nr.958 data 24.02.2026, Nr.1127 – data 12.03.2026 ku aritëm ti dalim ne ndihmë ketyre familjeve në Akomodim , pako ushqimore dhe higjien dhe drru zjari per ngrohje.
- Takim në Ministrin e punëve të brendshme per pagesat e vonuara për qiradhënësit për të Ri-atdhesuar
- Trajnim 3 ditor në Gjakovë „ Drejtësia Tranzicionale."- Në kuadër të projektit "Zërat e Resiliencës – Shërim, Drejtësi dhe Dinjitet për të mbijetuarit e dhunës gjatë konfliktit në Kosovë", I implementuar nga Medika Gjakova.

- Takimet e rregullta me Kryetarin e Komunës –me punëtorët e Komunës
- Takimi me Drejtorin e Administratës
- Takimet e rregullta me Asamblen e Fëmijëve /Rahovec – Ri freskim I Asambles së femijeve për arsye se gjeneratat po ndryshojn dhe tani kemi kerkuar nga Drejtoria e Arsimit që në Asamblen e fëmijëve të jenë pjesmarësit edhe nxënësit e shkollave rurale (nga fshatrat) dhe uroj se do të gjejme përkrahje për ti mbështetur për transport këta fëmijë.
- Puntori Asamblea e Femijeve ne Prizren -„shkëmbimi I provojave të punës Rahovec, Prizren , Suharek, Dragash”
- Takimet e regullta me zyrtarin Ligjor nga zyra e Avokatit te Popullit „Dita e hapur me qytetarin” çdo muaj , gjithashtu kemi mbajt Ligjerata në dy shkolla „Isa Boletini -Rahovec dhe Nagavc me nxenes dhe mësimdhenës, Tema me nxënës: Të Drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësit e tyre dhe me mesimdhenes ; „Ndëshkimet trupore”-

Sektori për Barazi Gjinore

Në kuadër të Administratës, funksion sektori për Barazi Gjinore, gjatë këtij gjashtë mujori të vitit 2026, zyrtari për barazi gjinore është angashuar në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas ashtu siç parashihen me Ligjet tona në fuqi dhe me Konventa Ndërkombëtare.

Përgjatë këtyre muajve, konfrom planit të punës për këtë vit, zyrtari ka bashkëpunuar me organizata vendore dhe të huaja, ka marrë pjesë në punëtori për avancimin e rolit të gruas në shoqëri, sektori për Barazi Gjinore, ka objektiv rritjen e rolit të gruas në shoqëri, avancimin e saj në shoqëri.

Ky raport paraqet aktivitetet dhe detyrat e realizuara gjatë periudhës janar – qershor 2026, në përputhje me planin e punës, objektivat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Barazi Gjinore në Komunën e Rahovecit.

- Dalje në teren si anëtar i komisionit me vendim të kryetarit, për vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga vërshimet e shiut, në fshatrat: Zatriq, Ratkoc, Çifllak, Dobidol, Kramovik, Bratotin, ku është bërë vlerësimi nga komisioni;
- Trajnim i organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, i dedikuar zyrtarëve kontaktues për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe unifikimin e praktikave në zbatim të legjislacionit në fuqi. Trajnimi u fokusua në: sistemin e ri elektronik për deklarimin e pasurisë, të zhvilluar nga Agjencia gjatë vitit 2025 dhe të funksionalizuar në fillim të vitit 2026;
- Takim pune me grupin e komisionit për vërshime, shqyrtimi i lëndëve në teren;
- Takim koordinues organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, me zyrtarët ministror dhe komunalë ZBGJ, ku u diskutuan prioritetet, aktivitetet e planifikuara dhe mënyrat konkrete të bashkëpunimit në periudhën në vijim;
- Marrja pjesë në Punëtorinë për ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e rregulloreve mjedisore, e cila u mbajt në Sallën e Kuvendit Komunal, në kuadër të zbatimit të projektit

“Be Clean Be Green”, i cili implementohet në partneritet nga Komuna e Haraçinës, Komuna e Rahovecit;

- Pjesëmarrës në punëtorin për hartimin e Planit Vjetor të Punë së Kuvendit të komunës së Rahovecit për vitin 2026, që parashihet me kornizën ligjore në Kosovë. Në këtë punëtori morën pjesë grupet parlamentare të partive të përfaqësuara në Komitetin për Politikë dhe Financa, drejtorët komunal dhe zyrtarët komunal, të cilët patën mundësi të bëjnë propozime për planin e punës së kuvendit;
- Dalje në teren si anëtar i Komisionit për Punë Inspektuese, për shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim, gjatë këtij tre mujori kemi pasur 4 lëndë me ankesa në Rahovec dhe në fshatin Xërxë;
- Trajnim në IKAP, tema e trajnimit ishte, Sistemi elektronik DMSA, Moduli për Konflikt të Interesit;
- Përgaditja e Raportit të Mekanizmit Koordinues Lokal kundër dhunës në familje për periudhën Korrik - Dhjetor 2025 - Komuna e Rahovecit;
- Mbledhja dhe vendosja në sistemin PMS e të dhënave për Performancë komunale për vitin 2025 për pjesën: Barazia në punësim dhe Përfaqësimi gjinor;
- Plotësim i pyetësor për zbatimin e standardeve evropiane të administratës në funksion të lehtësimit të barrës/ngarkesës administrative në Kosovë;
- Mbledhja e 1 (parë) e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026, më 3 mars, në sallën e KK- Rahovec;
- Njoftim për deklarimin e dhuratave për personat zyrtar që kanë për të deklaruar;
- **Aktivitet në kuadër të “Ditës ndërkombëtare të gruas – 8 Marsi:**
Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me shoqatën e gruas “Hareja”, organizuam tryezë të rrumbullakët me temën “Gra të forta përtej sfidave”. Në këtë aktivitet pjesëmarrës ishin gra dhe nëna të dëshmorëve, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme: arsimi, shëndetësia, policia, qendra për punë sociale, komuna, OJQ-të dhe gra asambleiste. Një aktivitet i dedikuar grave që kanë kontribuar në shoqëri me përkushtim, forcë dhe dinjitet. (pjesëmarrës ishin 28 gra dhe 1 burrë);
- Pjesëmarrës me ftesë nga Agjencia për Barazi Gjinore në punëtorinë e radhës së hartimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025-2035, ku u diskutua për prezantimin e masave/aktiviteteve për të tri shtyllat që përmban PKBGJ;
- Me rastin e ditës botërore të Autizmit dhe ditës botërore të Down Syndrome, shoqata “Hareja” në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, organizuan tryezën e rrumbullakët me temën: “Bashkëpunimi ndërinstitucional për përfshirjen, mbështetjen dhe përmirësimin e shërbimeve për personat me Autizëm dhe Down Syndrome”. Qëllimi i kësaj tryeze ishte të sjellë bashkë përfaqësues nga institucionet regjionale dhe komunale, për të diskutuar rolin e secilit institucion në ofrimin e shërbimeve për personat me Autizëm dhe Down Syndrome si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional;
- **Aktivitet** – Organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore, mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore. Trajnim me Këshillin Lokal për Siguri në Bashkësi rreth Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore; si dhe Ligji mbi familjen;
- Mbledhja e 1 (parë) - e Mekanizmit Komunal Koordinues kundër Dhunës në Familje për vitin 2026. Mbledhja u mbajt më 8 maj 2026, në sallën e kuvendit komunal Rahovec, ku u bë raportimi i statistikave nga Policia e Kosovës në Rahovec si dhe nga Qendra për punë sociale;

- Takim me grupin punues sipas vendimit të Kryetarit për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit për vitet 2027-2029. Qëllimi i takimit ishte koordinimi i aktiviteve lidhur me procesin e dëgjimeve buxhetore;
- Marrja pjesë në takimin e parë për vitin 2026 të Komitetit Komunal Veprues për implementimin e Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali 2023–2026;
- Pjesëmarrës si anëtar i grupit punues në degjimin buxhetor publik për përgatitjen e KAB (Kornizës afatmesme buxhetore 2027), në degjimet publike si, me: Kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane, në Sallën e Kuvendit Komunal- Rahovec; degjimi publik për buxhetimin gjinor me gra dhe vajza u mbajt në Kafiterin Moka - Rahovec; degjimi publik me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë, Kuvendi Komunal; degjimi publik me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerët dhe grupet e interesit që veprojnë në Komunën e Rahovecit, Kuvendi Komunal; degjimi publik me drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë, psikologët dhe pedagogët, Kuvendi Komunal; dëgjimi publik me punëtorët shëndetësorë, në QKMF, Rahovec;
- Përgaditja e Kornizës afatmesme buxhetore KAB 2027, me të dhënat për pjesën e buxhetimit gjinorë;
- Mbledhja e 2 (dytë) e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) më 10 qershor, në sallën e KK- Rahovec;
- Kryesues i Komisionit për punë Inspektuese me Vendim të Kryetarit të Komunës, Takim në zyre me anëtarët e komisionit për punë Inspektuese, qëllimi i takimit, shqyrtimi i një ankese për një lëndë në Drejtorinë për Inspektoriat, ku po të njejtën ditë dolëm edhe në teren së bashku me anëtarët e komisionit dhe inspektorët e lëndës, për të shikuar vendin për të cilin është bërë ankesa, në Rahovec, ku edhe pas shqyrtimit të lëndës si Komision morëm edhe Vendimin për ankesën e paraqitur.

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim në hapësirat e mbrendshme të objekteve të komunës, kujdes për gielbrim në hapësirat e jashtme etj.

Kemi menaxhuar me përkushtim të plotë fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar me përkushtim të plotë sipas legjislacionit në fuqi. mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servismin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimint me deprivate etj.

Drejtor për Administratë të Përgjithshme

Afrim Dina

